

KËRKESË
Nr. 3510, datë 28.10.2019

PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ SUBJEKTIT
“REJSI FARMA”

ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin e pezullimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë, duke u konfirmuar nga shërbimi postar, largimi i subjektit nga ajo adresë apo adresë jo e saktë.

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, bën njoftimin publik të vendimit përfundimtar të inspektimit të ISHMPUT-së, Dega Rajonale Tiranë, respektivisht për subjektin si më poshtë:

- Rejsi Farma.

KRYEINSPEKTOR I NGARKUAR
NË DETYRË
ISHMPUT, DEGA TIRANË
Evisjon Salku

VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. ISHMPUT-TR-2019-000697-5

Datë 27.9.2019

Bazuar në nenin 46, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe në procesverbalin e inspektimit nr. ISHMPUT-TR-2019-000697-2, datë 12.9.2019, inspektim që është zhvilluar në subjektin “Rejsi Farma”, me NIPT J91419001U, përfaqësues i autorizuar i subjektit z. Edvin Xhango, ekonomist, ID H21015112A, prej datës 6.9.2019, ora 09:00 deri në datën 6.9.2019, ora 14:00. Grupi i inspektimit, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit në datën 12.9.2019 dhe e njoftoi në datë 11.9.2019. Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe të kontestimeve të subjektit të inspektimit, rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore: ligji nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, neni 26, pika 6.

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit ***nuk ka***, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

Gjobë 1 000 000 lekë.

2. Dënim administrativ plotësues

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t’u realizuar me afate kohore respektive:

27.9.2019: të paraqesë pranë ISHMPUT-Tiranë informacionin periodik që duhet dërguar pranë AKM-së, çdo 3 muaj.

Inspektorët shtetërorë të autorizuar:

Besmir Stafa ID: ____

Arjan Cela ID: ____

Kundër vendimit përfundimtar, subjekti “Rejsi Farma” ka të drejtën e ankimit, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë organit epror, Komisionit të Ankimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.